

DEKRET
Nr.7399, datë 8.7.1990

**PËR NJË NDRYSHIM NË KODIN E PUNËS TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave

**PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 53 të Kodit të Punës të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Kur ndërprerja ndodh jo për faj të punëtorit dhe administrata e ndërmarrjes, e institucionit ose e organizatës shoqërore nuk i siguron një punë tjetër, për kohën e ndërprerjes punëtori merr 80 përqind të pagës kurse personeli drejtues administrativ, inxhiniero-teknik dhe ekonomik për faj të të cilit është shkaktuar ndërprerja e punës ose mospagëtimi i një pune tjetër mer gjysmën e pagës”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË**

SEKRETARI
SIHAT TOZAJ

KRYETARI
RAMIZ ALIA